



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT

KORÇË

VENDIM

Nr 60 Datë 15/08/2007

PËR

MIRATIM FONDI PËR KAMPIONATIN BALLKANIK TË
CIKLIZMIT (30 KORRIK – 2 GUSHT)

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës për "MIRATIM FONDI PËR KAMPIONATIN BALLKANIK TË CIKLIZMIT (30 KORRIK – 2 GUSHT)", bazuar në ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, pika "dh", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr 2 dt.02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 246.000 lekë për Kampionatin Ballkanik të Ciklizmit (30 Korrik – 2 Gusht).

2. Ky fond do të perballohet nga fondi i planifikuar për Teatrin për aktivitetin e « Festivalit të Komedisë », (aktiviteti i cili nuk do të zhvillohet) me këtë strukturë buxhetore :

<i>Pakësohet</i>	00	08250	05	Art 6020000	-246.000 lekë
<i>Shtohet</i>	00	01110	05	Art 6020000	+246.000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës në Bashki dhe Teatri "A.Z.Cajupi".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE